

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Flamingo në Bienalen Ndërkombëtare të Roterdamit - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/flamingo-ne-bienalen-nderkombetare-te-roterdamit/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 11:13:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 11:05:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4b31e15f62412f89881bdeda9117bb00843ebad28c63d73ddbef0640b1d93f17
TEKSTI	a89900157c5f1dde16ee6fa4e286b47fd0f4ff9984de850df62db61954c8d93e
PAMJA	64e6845a243ac56d08452f138849690973650457ac7f3ed12bac4b6522f32667

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1ec48b5efa32d5c436c0629e610fdfac0326093371bed1aa35f9c14ad4ecba74
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1e4bbdcc86bb83ba0aea314f2faba748589132b4289d9e2a8edd562c2fbc5c80
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1ec48b5efa32d5c436c0629e610fdfac0326093371bed1aa35f9c14ad4ecba74>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

[Home](#) [Aktualitet](#)

Flamingo në Bienalen Ndërkombëtare të Roterdamit

by **Sport Sport** — September 20, 2026 in Aktualitet, Politike0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Revolucioni Flamingo i Shqipërisë shkon në Bienalen Ndërkombëtare të Arkitekturës së Roterdamit 2026, 18 shtator – 29 nëntor 2026.

Kolektivi Artistët dhe Arkitektët Shqiptarë për Revolucionin Flamingo prezanton në Roterdam, “Ata thonë ‘Zhvillim’, Ne themi ‘Grabitje Toke’”, një ndërhyrje hapësinore që sjell zërin dhe materien e Revolucionit Flamingo në Bienale, drejtpërdrejt nga Shqipëria.

Ndërsa prej pothuaj 4 muajsh, shqiptarët kanë mbushur rrugët çdo ditë, në një lëvizje që tashmë njihet si Revolucioni Flamingo, nxitur fillimisht nga planet për ndërtimin e një resorti brenda një lagune të mbrojtur, banesë e flamingove dhe specieve të tjera, protesta është shtrirë përtej refuzimit të një projekti të vetëm, duke u shndërruar kështu në një revoltë më të gjerë kundër agjendës së zhvillimit të Kryeministrit Edi Rama, model ku interesat publike sakrifikohen gjithnjë e më shumë në favor të elitave të tjera.

Artistët që paraqesin veprën e tyre në Bienalen e Roterdamit, shfaqin materiale nga terreni të krijuara nga protestuesit gjatë protestave si pankarta origjinale përdorur në protestë (10 x 2 m), valëvitur nga aktivistët e Revolucionit Flamingo, përgjatë brigjeve të kërcënuara të Zvërnecit dhe ishullit të Sazanit, një tufë flamigosh – flamingo origjinale polistireni përdorur çdo natë nga protestuesit gjatë demonstratave si edhe kartolina nga Shqipëria – një grup kartolinash të cilat vizitorët janë të ftuar t'i dërgojnë drejt përfaqësuesve të BE-së, duke kërkuar shfuqizimin e Ligjit 21/2024, legjislacion që ka bërë të mundur ekspozimin e parqeve kombëtare dhe zonave të mbrojtura ndaj projekteve të mëdha turistike dhe infrastrukture.

Kolektivi e përdor hapësirën dhe kohën e Bienales si zgjatim mbështetjeje, si një mënyrë për ta bartur më tej lëvizjen dhe për ta lejuar atë të rrugëtojë përtej kufijve të Shqipërisë.

Pyetja kryesore që kolektivi ngre është: “Përtej thjesht përfaqësimit të lëvizjes Flamingo, si mundet një bienale arkitekture të mbështes një lëvizje që tashmë po prodhon format e veta të njohurive hapësinore, organizimit dhe rezistencës?”.

Kolektivi Artistët dhe Arkitektët Shqiptarë për Revolucionin Flamingo (AAAFR) është një grup fluid artistësh, arkitektësh dhe aktivistësh, që zuri fill në rrugët e Tiranës dhe të qyteteve të tjera përmes angazhimit të përditshëm me protestat, qysh kur nisi lëvizja.

Bienalja Ndërkombëtare e Arkitekturës në Roterdam, është një institucion kulturor që nxit dialogun mbi çështjet bashkëkohore hapësinore dhe organizon çdo dy vjet edicionet e saj tematike.

TË FUNDIT

Flamingo në Bienalen Ndërkombëtare të Roterdamit
SEPTEMBER 20, 2026

Hyri me disa të tjerë për të vjedhur në një banesë në Itali, pronari vret 25 vjeçarin shqiptar
SEPTEMBER 20, 2026

Atentati në Sarandë/ Kalimtarit që mbeti i plagosur nisat me helikopter në Tiranë
SEPTEMBER 20, 2026

Rrjeti e “masakroi” sikur po i thurte lavde Enverit, gruaja i përket një familjeje të persekutuar
SEPTEMBER 20, 2026

I shpallur në kërkim nga Gjermania, arrestohet në Morinë 34-vjeçari
SEPTEMBER 20, 2026

Ish-drejtori i CIA-s publikon shifrat tronditëse: 1.2 milionë ushtarë rusë të vranë dhe të plagosur në Ukrainë
SEPTEMBER 20, 2026

U vra me armë zjarri në Sarandë, Artan Myrtaj i njohur si “Tani i Ruzhdiut” rezultoi i arrestuar në 2025
SEPTEMBER 20, 2026

Autobusi plot me mallra kontrabandë/ Dy 43-vjeçarë në pranga në aksin Kakavijë-Gjirokastrë, sekuestrohen 22 mijë euro dhe 100 steka cigare
SEPTEMBER 20, 2026

Vrasje në Sarandë, ekzekutohet 42-vjeçari në qendër të qytetit, plagoset dhe një kalimtar
SEPTEMBER 20, 2026

U kapën duke kultivuar kanabis me vlerë 400 mijë paund, dënohen me burg 2 shqiptarët në Britani
SEPTEMBER 20, 2026

Hyri me disa të tjerë për të vjedhur në një banesë në Itali, pronari vret 25 vjeçar shqiptar



Sport Sport

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçar

01

0 SHARES



Skandali/ Policia rrugore shoqëron kamionët e Alesios në orarin e ndalimit të qarkullimit

0 SHARES



Falsifikime dhe shpërdorim detyre, pezullohen 2 zyrtarë në Tiranë

0 SHARES